



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**Këshilli Drejtues**

**V E N D I M**

**Nr.2655, datë 17.12.2015**

**Për**

**Heqjen e të drejtës së ofrimit të shërbimeve dhe të rrjeteve të komunikimeve elektronike si dhe çregjistrimin nga regjistri i sipërmarrësve të sipërmarrësit Bardhyl Tosku (Person Fizik).**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj.Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj.Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj.Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 17.12.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Heqjen e të drejtës së ofrimit të shërbimeve dhe të rrjeteve të komunikimeve elektronike si dhe çregjistrimin nga regjistri i sipërmarrësve të sipërmarrësit Bardhyl Tosku (Person Fizik).**

**BAZA LIGJORE:**

1. Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (ligji nr. 8485), i ndryshuar;
2. Neni 24, pika 3, Neni 30, pika 5 dhe Neni 135, pika 2, gërma b) të Ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918), i ndryshuar;

3. Rregullore Nr. 24 datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1774, datë 02.02.2012, ndryshuar me VKD të AKEP Nr.2429 datë 13.03.2014 dhe VKD Nr.2443 datë 10.04.2014;
4. Rregullore Nr.12, datë 07.04.2010. “Për të dhënat Statistikore dhe Financiare Periodike të Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”,
5. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

## K Ë SH I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Urdhër Nr.1390 Prot., datë 22.01.2015, “Për procedurën e inspektimit në distancë, administrimin e informacionit të përfutur dhe planifikimit të tematikës së inspektimit dhe monitorimit”;
2. Urdhër Nr. 1628, datë 27.11.2015 për “Kryerjen e verifikimit për përmbushjen e detyrimeve nga sipërmarrësit”;
3. Shkresa nr 180 prot. Datë 26.01.2015 me lëndë: Depozitim të pasqyrave financiare 2014.
4. Korespondenca me email të datës 04.03.2015, mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe Kushtet e Aksesit dhe përdorimit të faqes elektronike “web”.
5. Njoftimi në faqen web të AKEP me datë 04.09.2015 për sipërmarrësit që brënda datës 15.09.2015 duhet të:
  - Dorëzojnë në AKEP Bilancet financiare vjetore për vitin 2015;
  - Të ndërtojnë Faqe web-i nën domain cc.TLD.al, ( në se nuk e kanë një të tillë);
6. Relacioni shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacion**), si dhe

duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazën ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N

1. Me Urdhër Nr.1390 Prot., datë 22.01.2015, “Për procedurën e inspektimit në distancë, administrimin e informacionit të përfutur dhe planifikimit të tematikës së inspektimit dhe monitorimit”, është udhëruar kryerja e Inspektimit në distancë për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike;
2. Me Urdhër Nr. 1628, datë 27.11.2015 për “Kryerjen e verifikimit për përmbushjen e detyrimeve nga sipërmarrësit”, është udhëruar verifikimi i përmbushjes së detyrimeve nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike lidhur me: Publikimin e tarifave si dhe kushteve të aksesit e përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, informacionit për cilësinë e ofrimit të shërbimeve, të kushteve të përgjithshme të kontratave tip me pajtimtarin, depozitimin e bilanceve vjetore dhe kryerjen e pagesave në AKEP. Nga verikimi i kryer për sipërmarrësin e komunikimeve elektronike **Bardhyl Tosku (Person Fizik)**, me objekt verifikimin e zbatimit të:

- Kushteve të përcaktuara në Autorizimin e përgjithshëm lidhur me:

Adresa: Rr. “Abdi Toptani”  
Godina Torre Drin, Kati IX, Tiranë

Tel : + 355 4 2259 571  
Fax : + 355 4 2259 106

[www.akep.al](http://www.akep.al)  
[info@akep.al](mailto:info@akep.al)

- Bashkëveprimin e shërbimeve dhe interkoneksionin e rrjeteve;
  - Sigurimin e disponueshmërisë dhe përdorimin e numrave nga plani i numeracionit për përdoruesit fundorë;
  - Mbrojtjen e të dhënave vetjake dhe të privatësisë;
  - Mbrojtjen e përdoruesve;
  - Respektimin e rasteve të kufizimeve në lidhje me përmbajtjen e paligjshme ose të dëmshme;
  - Lejimin e përgjimit nga autoritetet kompetente;
  - Ofrimin e rrjeteve të komunikimeve publike në rastet e gjendjes së emergjencës;
  - Detyrimi për të ofruar akses;
  - Mbrojtjen e rrjeteve të komunikimeve publike ndaj aksesit të paautorizuar;
  - Detyrimin për të plotësuar standardet dhe specifikimet teknike të rrjeteve dhe të pajisjeve për ndërtimin e rrjeteve dhe ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike si dhe të shërbimeve të faciliteteve shoqëruese;
  - Regjistrimin e pajtimtarëve, ruajtjen dhe administrimin e të dhënave për qëllime të ndjekjes penale, etj;
- Kushteve të përcaktuara në Autorizimin Individual për përdorimin e frekuencave;
  - Kushteve të përcaktuara në aktet normative të AKEP lidhur me:
    - Publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve;
    - Kushteve të përgjithshme të kontratave tip me pajtimtarin.

3. Gjatë verifikimit është konstatuar se:

I. Sipërmarrësi **Bardhyl Tosku (Person Fizik)**, sipas Autorizimit Nr. **2012-AP-U178-8-8**, datë 12/07/2013 është regjistruar për të ofruar:

- A. *Rrjete publike të komunikimeve elektronike:*
  - *Rrjete publike tokësore fikse aksesi dhe transmetimi*
- B. *Shërbimeve publike të komunikimeve elektronike:*
  - *Aksesi në internet etj.*

II. Sipërmarrësit **Bardhyl Tosku (Person Fizik)** në zbatim të urdhrit të lartpërmendur i janë përcjellë disa herë njoftimet:

1. Shkresa nr 180 prot. Datë 26.01.2015 me lëndë: Depozitim të pasqyrave financiare 2014.
2. Korespondenca me email të datës 04.03.2015, mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe Kushtet e Aksesit dhe përdorimit të faqes elektronike “web”.
3. Njoftimi në faqen web të AKEP me datë 04.09.2015 për sipërmarrësit që brënda datës 15.09.2015 duhet të:
  - Dorëzojnë në AKEP Bilancet financiare vjetore për vitin 2015;
  - Të ndërtojnë Faqe web-i nën domain cc.TLD.al, (në se nuk e kanë një të tillë).

III. Në përfundim të verifikimit të zbatimit të detyrimeve të sipërmarrësit, dhe duke patur parasysh dokumentacionin e dorëzuar në AKEP në zbatim të rregullores dhe ligjit nr. 9918, i ndryshuar, rezulton se, sipërmarrësi **Bardhyl Tosku (Person Fizik)**:

1. Ka Faqe web-i të ndërtuar por pa informacionet e duhura të publikuara në zbatim të Rregullores nr. 27, datë 21.9.2012 “Mbi Publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike” e ndryshuar;
2. Nuk ka raportuar të dhënat statistikore për vitin 2015 në zbatim të Rregullores nr.12, datë 7.4.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” e ndryshuar;

Grupi i punës, bazuar në:

- Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
- Rregullore “Për Autorizimin e Përgjithshëm” Nr. 24 datë 02.02.2012 miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1774, datë 02.02.2012, ndryshuar;
- Rregullore Nr.12, datë 07.04.2010 “Për të dhënat Statistikore dhe Financiare Periodike të Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”,
- Rregulloren nr. 27, datë 21.9.2012 “Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve”.

Ka vendosur t’i propozojë Këshillit Drejtues të AKEP, heqjen e të drejtës së ofrimit të shërbimeve dhe të rrjeteve të komunikimeve elektronike si dhe çregjistrimin e sipërmarrësit **Bardhyl Tosku (Person Fizik)**, nga regjistri i sipërmarrësve.

IV. Këshilli Drejtues i AKEP, pasi shqyrtoi materialet pjesë përbërëse të kësaj praktike si dhe konkluzionet e arritura në përfundim të procesit të verifikimit, vlerëson se, sipërmarrësi **Bardhyl Tosku (Person Fizik)**, është në shkelje të detyrimeve të parashikuara nga ligji nr. 9918/2008 i ndryshuar, konkretisht Neni 24, pika 3, Neni 30, pika 5, Neni 54, Neni 98, dhe rregulloret e nxjerra në zbatim të tij si më lartpërmendur.

### PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 1 të nenit 114 dhe nenit 115 të ligjit Nr. 9918:

### V E N D O S:

1. Të miratojë heqjen e të drejtës së ofrimit të shërbimeve dhe të rrjeteve të komunikimeve elektronike si dhe çregjistrimin nga regjistri i sipërmarrësve të sipërmarrësit **Bardhyl Tosku (Person Fizik)**;
2. Të njoftohet sipërmarrësi **Bardhyl Tosku (Person Fizik)**, për zbatimin e këtij Vendimi;

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Tiranës, sipas Legjislacionit në fuqi;
4. Efektet e këtij vendimi fillojnë 60 ditë pas njoftimit të këtij Vendimi dhe publikimit të tij në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R**

**Piro XHIXHO**

**ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:**

1. **Alban KARAPICI** \_\_\_\_\_
2. **Anila DENAJ** \_\_\_\_\_
3. **Ketrin TOPÇIU** \_\_\_\_\_
4. **Klarina ALLUSHI** \_\_\_\_\_